

*Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore*, është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i krijuar nga Ligji Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, dhe Vendim Nr. 364, datë 29.5.2019 i Këshillit të Ministrave “Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, dhe ka selinë në Tiranë.

Struktura dhe organika e IKT-së është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit, nr. 137, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”.

Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë administrative e shkencore në IKTK realizohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

IKTK-ja funksionon në bazë të dispozitave të ligjit nr. 27/2018, VKM nr. 264/2019, Statutit si dhe Rregullores së miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

IKTK-ja ka si mision gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.

IKTK-ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë vijon:

- a) të trashëgimisë kulturore materiale;
- b) të arkeologjisë parandaluese të shpëtimit nëntokësor dhe nënujor;
- c) të pasurisë e peizazhit kulturor.

IKTK-ja e shtrin veprimtarinë e tij për trashëgiminë kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror. Në përbërje të strukturës së tij ka edhe Qendrën Rajonale për Konservim dhe Restaurim, që kryen këto funksione:

- a) formon dhe përditëson njohuritë e restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- b) harton dhe zbaton programe të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

IKTK-ja, për të kryer funksionet sipas ligjit, mbledh tarifat, sipas parashikimeve të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

IKTK funksionon si Sekretaria Teknike dhe Sporteli Unik për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Veprimtaria dhe administrimi i IKT-së auditohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe institucione të tjera të ngarkuara me ligj, për auditim.

Punësimi në IKTK bëhet sipas rregullave të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me kontratë individuale pune sipas nevojave administrativo-institucionale si dhe në përputhje me legjisllacionin shqiptar në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës.

*Në lidhje me veprimet ose mosveprimet e IKTK ju keni të drejtë t'i drejtoheni gjykatës në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ.*